



This project is funded by  
the European Union



Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit "Mbështetje për Standardet e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare" dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# SI TË MBRONI PARCELËN NGA MIZA E ULLIRIT



## BIOLOGJIA E DËMTUESIT



Miza e ullirit *Bactrocera oleae* (Rossi) është një dëmtues monofag. Në kushtet klimaterike të vendit tonë zakonisht miza ka 3-4 brezni, ku dëmin kryesor e shkakton breznia e dytë. Insekti i rritur del nga pupa dimëruese në qershor-korrik ushqehet me eksudate vegjetale dhe melasa arrin pjekurinë seksuale, kopulohet dhe vendos vezët në kokrrat ullirit gjatë fazës së drunjzimit të bërthamës. Nga këto vezë çelin larvat që rriten duke u ushqyer me tulin e kokrrës dhe pasi përfundojnë zhvillimin, kthehen në pupë nga të cilat dalin mizat e breznsisë së parë, që fillojnë vendosjen e vezëve të breznsisë së dytë, e kështu me radhë. Një femër vendos rreth 100-250 vezë në brendësi të kokrrave.

Shirat e para të gusht-shtatorit dhe ulja e temperaturave krijojnë kushte favorizuese për mizën. Gjatë periudhës shtator-nëntor shkalla e infeksionit në kokërr rritet me shpejtësi. Larva e insektit hap galeri në kokërr duke konsumuar deri 15% të tullit, ngjyra e saj varion midis të bardhës dhe të verdhës deri në të purpurt.



Në ullinjtë për tryezë edhe një shpim i vetëm mund të sjellë deformimin e kokrrës, prandaj ndërhyrja duhet të bëhet në kohën e duhur, sapo vërehen shpimet e para.

Në ullinjtë për vaj kryhen trajtimet kuruese (kundër larvave) në momentin e kalimit të pragut në fazat e para të zhvillimit të mizës (vezë dhe larva të moshës së parë) me Acetamiprid ose Spinosad. Maksimumi behën 3 trajtime në vit, duke alternuar rreshtat që trajtohen (jo gjatë lulëzimit dhe mundësisht në mbrëmje). Koha e karencës e PMB-së është 7 ditë.

Ritheksojmë që një nga masat kryesore mbrojtëse ndaj Mizës së ullirit mbetet vjelja e hershme e prodhimit.



## MASAT KURATIVE

### METODA BIOLOGJIKE


Kurthet për kapje në masë duke përdorur metodën "Josh dhe vrit" me anën e kurtheve me feromone dhe me deltametrinë ose lambdacialotrina.

Trajtimet me *Opius concolor* (lëshime të programuara me qendrat e këshillimit) ose të *Beauveria bassiana*.

### METODA KIMIKE

Është mënyra më efikase për kontrollin e popullatës së mizës kur kryhet në kohën e përshtatshme dhe në sipërfaqe të gjera. Parimi bazë i këtij trajtimi është zhdukja e mizës, para se femrat të vendosin vezët në frut. Për këtë është e nevojshme të vërehet dhe të monitorohet dendësia e popullatës nëpërmjet kampionimit të frutave të ullirit, vendosjes së kurtheve ose grackave të ndryshme tërheqëse. Kufijtë e këshilluar të ndërhyrjes janë:

- Për ullinjtë e tavolinës, kur vërehen shpimet e para.
- Për ullinjtë e vajit 10-15% e infeksionit aktiv gjatë muajit shtator-tetor.



## DËMI



**Gjatë viteve me shkallë të lartë infeksioni mund të ketë edhe humbje totale të prodhimit.**

- Shpimet për vendosjen e vezëve dhe vrimat e daljes së insektit të rritur hapin rrugë për depërtimin e patogjeneve të ndryshme;
- Gjithashtu galeritë e hapura në tul nga larvat shkaktojnë rrudhosje në kushtet e një klime të thatë, ose kalbje të kokrrës kur ka shira; për pasojë kokrrat rrëzohen në tokë;

**Në ullinjtë për tryezë edhe një shpim i vetëm mund të sjellë deformimin e kokrrës, duke ulur vlerën e prodhimit.**

- Efekti i infeksionit nga miza e ullirit në rendimentin e vajit të prodhuar nga bima varion nga 3 në 20% në varësi të kultivarit, nivelit dhe llojit të infeksionit. Dëmtimi i kokrrës së ullirit prej larvave shkakton rritjen e aciditetit të lirë, numrit të peroksideve si dhe aromë të pakëndshme (myku) në vaj, duke ulur vlerat ushqimore dhe tregtare të tij.





## KONTROLLI I DËMTUESIT

Për mbrojtjen e bimëve nga insekti dëmtues në kuadër të metodës së integruar të kontrollit të dëmtuesit masat ndahen në;

- preventive (parandaluese)
- kurative (drejtpërdrejta)

### MASAT PARANDALUESE

- Përzgjedhja e kultivarëve më pak të prekshëm;
- Mbjellja e ndarë e varieteteve për vaj dhe për tavolinë;
- Vjelja e hershme e ullirit për ngrënie në muajin shtator dhe e ullirit për vaj në muajin tetor;
- Punimi i tokës gjatë stinës së dimrit, pasi pakëson rezervën dimëruese në tokë (pupat dimëruese), si dhe përfundimi i vjeljes së kokrrave të mbetura sepse krijojnë kushte për dimërimin e dëmtuesit.

## KONTROLLI I MIZËS SË ULLIRIT

Kontrolli i mizës së ullirit bëhet nëpërmjet monitorimit të dëmtuesit dhe vlerësimit të dendësisë së popullatës së tij. Monitorimi i popullatës së mizës bëhet duke kapur insektin e rritur me anë të:

- kurtheve kromotropike.
- kurtheve me feromone seksuale me proteina-karrem të helmëta duke i vendosur qysh në infeksionet e para.
- kampionimit të frutave të ullirit.

